



**MINISTRIA E PUNËVE TE JASHTME  
DHE ZHVILLIMIT NDERKOMBËTAR**

-----  
**AMBASADA E FRANCËS NË KOSOVË**  
-----

*Departamenti për bashkëpunim dhe veprimtari kulturore*

**Thirrje për aplikim : bursa të qeverisë së Francës 2017**

**Bursa të qeverisë së Francës**

Ambasada e Francës në Kosovë ofron çdo vit bursa për studime Doktoratë, tezë në bashkëmentoring dhe Master. Dosja për aplikim duhet derguar Zonjës Cécile Fisteberg, Këshilltare për Bashkëpunim dhe Veprimtari Kulturore.

- Përbërja e dosjeve të kandidaturës për regjistrim në Doktoraturë: një CV, një letër motivuese, përshkrimi i projektit, kopja e diplomës së fundit dhe pasqyra e notave, në qoftë se është e mundur dëshminë e dy profesorëve mbikëqyrës të ardhshëm (në Prishtinë dhe në Francë) të cilët angazhohen të përcjellin punën tuaj shkencore.

- Përbërja e dosjeve të kandidaturës për regjistrim në Master: CV, një letër motivuese, kopja e diplomës së fundit dhe pasqyra e notave, përshkrimi i projektit Master në universitetin e përzgjedhur, programi i studimeve dhe përgjegjësi i Masterit tuaj.

Dosja juaj e aplikimit mund të përmbajë rekomandimin e një profesorit ose udhëheqësit të departamentit të studimeve tuaja. Aplikuesit që kanë njohuri të nivelit B1/B2 në gjuhë frënge ose ata që tregojnë interes për të mësuar gjuhën frënge kanë përparësi.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është data 15 maj 2017.

Bursat janë të vlefshme për një periudhë 1 vjeçare, me mundësi vazhdimi, në funksion të rezulateve të vitit universitar paraparak. Juria do të shqyrtojë aplikimet më datë 22 maj 2017. Aplikantët do të ftohen për intervistë në Ambasadën e Francës nga data 29 maj 2017 dhe rezultatet përfundimtare do të publikohen në muajin qershor.

Kontakt:

Zonja Cécile Fisteberg [cecile.fisteberg@diplomatie.gouv.fr](mailto:cecile.fisteberg@diplomatie.gouv.fr)

Informacione shtesë :

Zonja Fikrije Pllashniku [fikrije.pllashniku@diplomatie.gouv.fr](mailto:fikrije.pllashniku@diplomatie.gouv.fr)

Zonja Agathe Bouchet [agathe.bouchet@diplomatie.gouv.fr](mailto:agathe.bouchet@diplomatie.gouv.fr)

Për më shumë informata, web faqe Campus France :

<http://www.campusfrance.org/fr/rubrique/etudier-en-france>